



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 13

Lizingët (lizingu)

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që për marrësit dhe dhënësit e lizingut t'i përshkruajë politikat e duhura kontabël dhe shpalosjet që përdoren në lidhje me finansimin dhe lizingët operues.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të përdoret në kontabilitet për lizingët.
2. Ky standard nuk përdoret në transaksionet e specializuara në Kosovë midis subjekteve shtetërore dhe ndërmarrjeve komerciale të përfshira në miniera, punët gurthyese ose në transferin e të drejtave të mineraleve.
3. Ky standard nuk përdoret për transaksionet e specializuara që përfshijnë aranzhmanet e përbashkëta midis sektorit publik dhe atij privat, përfshirë këtu aranzhmanet për ndërtim, zotërim, operim dhe transfer të pasurisë.

Përkufizimet

4. Shprehjet vijuese përdoren në këtë standard me këto kuptime specifike:

Lizingu është një marrëveshje ku lizingdhënësi i huazon lizingmarrësit - si kundërvlerë për pagesë ose një numër të pagesave - të drejtën që të përdorë një pasuri për një periudhë të caktuar kohore.

Lizingu financiar është lizingu që i transferon kryesisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e ndodhura pronarit të pasurisë. Titulli mundet ose jo që të transferohet përfundimisht.

Një **lizing** operues është lizing tjetër nga ai financiar.

Lizingu i paanulueshëm është lizingu që anulohet vetëm:

- (a) pas ndodhjes së disa pasigurive të largëta
- (b) me lejen e lizingdhënësit
- (c) nëse lizingmarrësi hyn në një lizing të ri për një pasuri të njejtë ose ekuivalente nga lizingdhënësi i njejtë, ose
- (d) pas pagesës së një shume shtesë nga lizingmarrësi ashtu që, qysh në fillim, vazhdimi i lizingut të jetë i sigurtë në mënyrë të arsyeshme.

Fillimi i lizingut është data më e hershme e marrëveshjes ose zotimi nga palët për dispozitat kryesore të lizingut.

Afati i lizingut është periudhë që nuk mund të anulohet, për çka lizingmarrësi ka kontraktuar për të marrë në lizing pasurinë me çfarëdo kushtesh të mëtejme për të cilin lizingmarrësi ka opcion për ta vazhduar lizingun e pasurisë. Megjithatë, duhet të jetë e arsyeshme bindja se lizingmarrësi do ta ushtrojë opcionin për ta vazhduar afatin.

Pagesat minimale të lizingut janë pagesat gjatë afatit të lizingut për të cilat lizingmarrësi është i kërkuar ose mund të kërkohej, që t'i bëjë së bashku:

- (a) në rastin e lizingmarrësit, me çfarëdo shumash të garantuara nga lizingmarrësi ose nga pala e lidhur me lizingmarrësin; ose
- (b) në rastin e lizingdhënësit, çdo vlerë e mbetur që u është garantuar për lizingdhënësin qoftë nga:
 - (i) lizingmarrësi;
 - (ii) pala e lidhur me lizingmarrësin; ose

- (iii) nga një palë e tretë e pavarur që financiarisht është e aftë që për të përmbushur garancinë

Sidoqoftë, pagesat minimale të lizingut janë totali i të vijueshmeve:

- (a) pagesat minimale të lizingut të pagueshëm përgjatë afatit të lizingut, dhe
- (b) pagesa e kërkuar për ta kryer opcionin e blerjes

Nëse lizingmarrësi e ka një opcion që ta blejë pasurinë me një çmim që pritet të jetë mjaft më i ulët se sa vlera e fer më datën kur opcionin bëhet i ushtrueshëm dhe se është i sigurt se do të bëhet kjo.

Vlera fer është shuma për të cilën një pasuri mund të këmbehet ose obligimi të vendoset, midis të njohurve, palëve që e dëshirojnë një transaksion “duarlibër”.

Transaksioni “duarlibër” është transaksioni midis palëve të pa ndërlidhura, ku secili vepron sipas interesit vetanak.

Jeta ekonomike është :

- (a) periudha gjatë së cilës një pasuri pritet të jetë e përdorshme ekonomikisht nga një ose më tepër përdorues; ose
- (b) numri i prodhimeve ose njërive të ngjashme që pritet të fitohen prej pasurisë nga një ose më tepër përdorues.

Jeta e përdorimit është periudha që vlerësohet të ketë mbetur prej fillimit të afatit të lizingut, në të cilën priten të mirren nga ndërmarrja benificionet ekonomike të trupëzuara në pasuri. Jeta e dobishme nuk është e kufizuar nga afati i lizingut.

Vlera e mbetur e garancisë është:

- (a) në rastin e lizingmarrësit, pjesa e vlerës së mbetur që garantohet nga lizingmarrësi ose nga pala që është në lidhje me lizingmarrësin. Shuma e garancisë është shuma maksimale që mund të bëhet e pagueshme.
- (b) në rastin e dhënësit të lizingut, pjesa e vlerës së mbetur që garantohet nga lizingmarrësi ose nga pala e tretë që nuk është në lidhje me lizingdhënësin e i cili është i aftë financiarisht për të përmbushur garancinë.

Vlera e mbetur e pagarrantuar është pjesë e vlerës së mbetur që nuk garantohej ose garantohej vetëm nga pala që është në lidhje me lizingdhënësin.

Investimi bruto në lizing për lizingdhënësin është grumbullimi:

- (a) i pagesave minimale të lizingut, dhe
- (b) çdo vlerë e mbetur e pagarrantuar e akumuluar për lizingdhënësin.

E hyra financiare e pafiturar është ndryshimi midis:

- (a) investimit bruto në lizing, dhe
- (b) vlerës së tashme të investimit bruto në lizing, me shkallë të interesit të inkuadruar në lizing

Investimi neto në lizing është investimi bruto në lizing minus e ardhura financiare e pafiturar.

Shkalla e interesit e inkuadruar në lizing është shkalla e lirit që qysh në fillim të lizingut bën që totali vijues të jetë i barabartë me vlerën fer të pasurisë së marrë në lizing:

- (a) pagesat minimale të lizingut, dhe
- (b) vlera e mbetur e pagarrantuar

Shkalla inkrementale e interesit të huazimit për lizingmarrësin është shkalla e interesit që do ta kishte paguar lizingmarrësi për një lizing të ngjajshëm. Nëse nuk e disponojmë atë informatë, atëherë është shkalla ajo që lizingmarrësit do t'i ndodhte sikur të huazonte me kushte të ngjajshme, shumën e fondeve të nevojshme për të blerë pasurinë.

Klasifikimi i lizingëve

5. Klasifikimi i lizingëve të pranuar në këtë standard bazohet në faktin se ku ndodhet pronësia e pasurisë së lizingut, tek lizingmarrësi apo tek lizingdhënësi.
6. Lizingu klasifikohet si lizing financiar nëse i transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që i ndodhin pronësisë. Lizingu klasifikohet si lizing operues, nëse nuk i transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet që i ndodhin pronësisë.

7. Nëse lizingu është lizing financiar apo lizing operues, varet më tepër nga përmbajtja e transaksionit se sa nga forma e kontratës. Shembujt e situatave që normalisht do të bënin që lizingu të jetë klasifikuar si lizing financiar janë:
- (a) lizingu që i transferon pronësinë e pasurisë lizingmarrësit në fund të afatit të lizingut;
 - (b) lizingmarrësi ka opcion që ta blejë pasurinë me çmim që pritet të jetë mjaft më i ulët se sa vlera fer më datën kur opcioni bëhet i ushtrueshëm, sa që është e arsyeshme bindja që opcioni do të ushtrohet;
 - (c) afati i lizingut është pjesa më e madhe e jetës ekonomike të pasurisë, madje edhe nëse titulli nuk transferohet;
 - (d) në fillim të lizingut, vlera e tashme e shumave të pagesave minimale të lizingut i arrin thelbësisht, së paku, të gjitha nga vlerat fer të pasurisë së dhënë në lizing;
 - (e) pasuritë e dhëna në lizing janë të natyrës së tillë të specializuar që vetëm lizingmarrësi mund t'i përdorë pa bërë modifikime të mëdha
8. Klasifikimi i lizingut bëhet në fillim të lizingut.
9. Lizingët e tokës dhe të objekteve klasifikohen si lizingë operuese ose financiare në të njëjtat mënyra si lizingët e pasurive të tjera.

Lizingët në pasqyrat financiare të lizingmarrësit

Lizingët financiare

10. Lizingmarrësi duhet ta njohë lizingun financiar si pasuri dhe detyrim në pasqyrat e bilancit. Shuma që njihet është më e ulët në fillim të lizingut të:
- (a) vlerës fer të pronës së dhënë në lizing, ose
 - (b) vlerës së tashme të pagesave minimale të lizingut.

Gjatë llogaritjes së vlerës së tashme të pagesës minimale të lizingut faktori diskontues është shkalla e interesit të inkuadruar në lizing. Faktori diskont është shkalla, e cila shkakton që vlera e tashme e pagesës së lizingut të jetë e barabartë me vlerën fer të pasurisë. Nëse shkalla e inkuadruar nuk mund të përcaktohet praktikisht, duhet të përdoret shkalla inkrementuese e huazimit të lizingmarrësit.

11. Transaksionet dhe ngjarjet e tjera përlllogariten dhe paraqiten konform me realitetin thelbësor dhe financiar dhe jo vetëm me formën ligjore. Në disa raste forma ligjore e marrëveshjes për lizing mund të caktojë që lizingmarrësi mund të mos e sigurojë titullin ligjor të pasurisë së dhënë në lizing. Edhe pse dokumenti juridik mund ta thotë këtë në rastin e lizingut financiar, realiteti thelbësor dhe financiar është ai që lizingmarrësi i siguron përfitim ekonomik të përdorimit të pasurisë së dhënë në lizing për pjesën më të madhe të jetës së saj ekonomike si kthim për një obligim për të paguar një shumë të përafërt me vlerën e drejtë të pasurisë dhe ngarkesave financiare që lidhen me të. Trajtimi në kontabilitet duhet ta paraqesë thelbin ekonomik të transaksionit dhe mund të mos jetë në të gjitha rastet konform me qëndrimet e bëra në dokumentet e lizingut.
12. Nëse transaksionet e lizingut financiar nuk trajtohen si duhet në pasqyrën e bilancit të lizingmarrësit, burimet ekonomike dhe obligimet e ndërmarrjes janë të nënvlerësuara. Prandaj është e përshtatshme që lizingu financiar të njihet në pasqyrën e bilancit të lizingmarrësit edhe si një pasuri, por edhe si detyrim për t'i paguar pagesat e lizingut në të ardhmen. Në fillim të lizingut, pasuria dhe detyrimi për pagesat e lizingut në të ardhmen njihen në pasqyrën e bilancit si shuma të njëjta.
13. Pagesat e lizingut duhet të shpërndahen ndërmjet ngarkesës financiare dhe zvogëlimit të detyrimit të papaguar. Ngarkesa financiare duhet të alokohet në periudha gjatë afatit të lizingut ashtu që të prodhojë vazhdimisht shkalla periodike të interesit në bilancin e mbetur të detyrimit për çdo periudhë.
14. Në praktikë, në alokimin e ngarkesës financiare në periudha gjatë afatit të lizingut, disa forma të vlerësimit të përafërt mund të përdoren për ta thjeshtësuar llogaritjen.
15. Lizingu financiar e bën rritjen e shpenzimeve të zhvlerësimit për pasuritë e zhvlerësueshme si dhe të shpenzimeve financiare për çdo periudhë përlllogaritëse. Politika e zhvlerësimit për pasuritë e amortizueshme të dhëna në lizing duhet të jenë konsekuente me faktin përse janë të pronësuara pasuritë e zhvlerësueshme.
16. Nëse ekziston bindje e arsyeshme se lizingmarrësi do ta marrë pronësinë në fund të afatit të lizingut, periudha e pritur e përdorimit është jeta e dobishmërisë së pasurisë, përndryshe pasuria zhvlerësohet gjatë afatit më të shkurtër të lizingut ose jetës së saj të dobishmërisë.
17. Shuma e shpenzimit të zhvlerësimit për pasuri dhe shpenzimi financiar për periudhë, rrallë janë të njëjta si të pagueshmet e pagesave të lizingut për periudhë dhe kjo është, prandaj, e papërshtatshme, thjesht, për të njohur të pagueshmet e pagesave të lizingut si një shpenzim në pasqyrën

e të ardhurave. Rrjedhimisht, pasuria dhe detyrimet që kanë të bëjnë me të nuk duket të jenë të barabarta në shumë pas fillimit të lizingut.

Lizingët operues

18. Pagesat e lizingut nën lizingun operues duhet të njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave në baza ligjore gjatë afatit të lizingut.

Lizingët në pasqyrat financiare të lizingdhënësit

Lizingët financiare

19. Dhënësit e lizingut duhet ta njohin pasurinë e mbajtur si lizing financiar në pasqyrën e bilancit dhe ta paraqesin atë si një të arkëtueshme në vlerë të barabartë me investimin neto në lizing.
20. Nën lizingun financiar thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e ndodhura në pronë ligjore i transferohen lizingdhënësit dhe kështu e arkëtueshmja e pagesës së lizingut trajtohet nga lizingdhënësi si pagesë e ekuitetit dhe e ardhur financiare për të kompensuar dhe shpërblyer lizingdhënësin për investimet dhe shërbimet e tij.
21. Njohja e së hyrës financiare duhet të bazohet në modelin që reflekton fitim periodik e konstant në investimet neto të mbetura të lizingdhënësit në lizingun financiar.
22. Pagesat e lizingut lidhur me periudhën në kontabilitet përdoren kundër investimeve bruto në lizing për t'i zvogëluar të dyjat: ekuitetin dhe të ardhurën financiare të pafituar.

Lizingët operuese

23. Dhënësit e lizingut duhet t'i pasqyrojnë pasuritë që janë subjekt i lizingut operues në pasqyrat e bilanceve të tyre sipas llojit të pasurisë.
24. E ardhura e lizingut nga lizingu operues duhet të njihet në të ardhura në bazë lineare gjatë afatit të lizingut.
25. Kostot - përfshirë zhvlerësimin - që ndodhin gjatë fitimit të së hyrës së lizingut njihen si shpenzim. E ardhura e lizingut njihet në të ardhur në bazë lineare gjatë afatit të lizingut edhe nëse pranimet nuk janë në një bazë të tillë. E hyra e lizingut i përjashton pranimet për shërbimet e siguruar, siç janë sigurimi dhe mirëmbajtja.

26. Zhvlerësimi i pasurisë së zhvlerësueshme të dhënë në lizing duhet të jetë në bazë të vazdhueshme me politikën normale të zhvlerësimit të lizingdhënësit për pasuri të ngjashme.

Shpalosja

Lizingët financiare - lizingmarrësi

27. Lizingmarrësi duhet të bëjë shpalosjet vijuese si shtesë të çfardo shpalosjeje të kërkuar me SKK 14 “Instrumentet Financiare”:
- (a) Për secilin lloj të pasurisë, vlerën bartëse neto më datën e pasqyrës së bilancit
 - (b) Harmonizimin midis totalit të pagesave minimale të lizingut në datën e pasqyrës së bilancit dhe vlerën e tyre të tashme. Në shtesë të kësaj, ndërmarrja duhet të shpalos totalin e pagesave minimale të lizingut në datën e pasqyrës së bilancit, për çdo periudhë vijuese:
 - (i) jo më vonë se një vit
 - (ii) më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet
 - (iii) më vonë se pesë vjet
 - (c) Përshkrimin e përgjithshëm të aranzhmaneve të rëndësishme të lizingut të lizingmarrësit duke i përfshirë - pa u kufizuar në to - të vijueshmet:
 - (i) ekzistenca dhe kushtet e përtërirjes së blerjes së opsioneve dhe klauzolat me shkallë lëvizëse, dhe
 - (ii) kufizimet e caktuara me aranzhmanet e lizingut
28. Pos kësaj, kërkesat për shpalosje sipas SKK 3 “Patundshmeritë, impiantet dhe pajisjet” zbatohen për shumat të pasurisë së dhënë në lizing nën lizingët financiare që janë përlogaritur nga lizingmarrësi si marrje e pasurive.

Lizingët Financiare - lizingdhënësi

29. Dhënësit e lizingut duhet t'i bëjnë shpalosjet vijuese në vazhdim të çdo shpalosjeje të kërkuar nga SKK 14 “Instrumentet Financiare”:

- (a) harmonizimin midis totalit të investimit bruto në lizing më datën e pasqyrës së bilancit dhe të vlerës së tashme të kërkesës së pagesave minimale të lizingut në pasqyrën e bilancit. Në vazhdim të kësaj, ndërmarrja duhet ta shpalosë totalin e investimit bruto të lizingut më datën e pasqyrës së bilancit, për secilën prej periudhave vijuese:
 - (i) Jo më vonë se një vit
 - (ii) Më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet
 - (iii) Më vonë se pesë vjet
- (b) të ardhurën financiare të pafituar

Lizingët operuese – lizingmarrësi

30. Marrësit e lizingut duhet t'i bëjnë shpalosjet vijuese në vazhdim të çdo shpalosjeje të kërkuar me SKK 14 "Instrumentet Financiare":
- (a) totali i pagesave minimale të lizingut në të ardhmen nën lizingët operuese të pa-anulueshme për secilën nga periudhat vijuese:
 - (i) jo më vonë se një vit
 - (ii) më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet
 - (iii) më vonë se pesë vjet
 - (b) përshkrimi i përgjithshëm i aranzhmaneve të rëndësishme të lizingut të lizingmarrësve duke përfshirë - por pa u kufizuar – të vijueshmet:
 - (i) ekzistenca dhe kushtet e ripërtërirjes ose të blerjes së opsioneve dhe klauzolat me shkallë lëvizëse, dhe
 - (ii) kufizimet e caktuara nga aranzhmanet e lizingut

Lizingët operuese – lizingdhënësi

31. Dhënësit e lizingut duhet t'i bëjnë shpalosjet vijuese në vazhdim të çdo shpalosjeje të kërkuar me SKK 14 "Instrumentet Financiare": Pagesat minimale të lizingut në të ardhmen nën lizingët operuese të paanulueshme në tërësi dhe për secilën nga periudhat vijuese:
- (i) jo më vonë se një vit

(ii) më vonë se një vit dhe jo më vonë se pesë vjet

(iii) më vonë se pesë vjet

Përshkrim të përgjithshëm të aranzhmaneve të rëndësishme të lizingut të lizingdhënësit

Data e hyrjes në fuqi

32. Ky standard hyn në fuqi për raportet financiare që i mbulojnë periudhat prej 1 janar 2002 e tutje. Përkrahet zbatimi i mëhershëm.